



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PATOS  
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 3388/7 Prot.

Patos më 23.09.2024.

PROCESVERBAL

MBI MIRATIMIN E RENDIT TË DITËS SË MBLEDHJES SË DATËS 17.09.2024

I mbajtur sot më datë 17.09.2024 në orën 14:00 në sallën e mbledhjeve të Këshillit ku zhvillohet mbledhja e Këshillit të Bashkisë:

Prezent në fillimin e mbledhjes këta këshilltare:

1. Albiona Lamaj
2. Klaudio Alisinanaj
3. Liljana Mestuj
4. Erald Çepele
5. Lori Musaj
6. Artan Velçani
7. Klarida Semanjaku
8. Armand Ahmetaj
9. Ertilla Myrtaj
10. Smerald Hazizaj
11. Elmira Rama
12. Renaldo Shpata
13. Vjollca Kasaj
14. Novrus Toska
15. Zejni Musaj

Takimi hapet nga kryetari i Këshillit z. Armand Ahmetaj.

Armand Ahmetaj – Përshëndetje të gjithëve!

Të nderuar koleg këshilltarë!

Të nderuar specialistë të administratës!

Kjo është mbledhja e radhës e këshillit bashkiak. Mbledhja është e bazuar në ligjin 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, nenin 53 pika 4 të neni 56 pika 2.

Mbledhja konsiderohet e hapur.

Paraprkisht bëjmë një prezencë të pjesëmarrjes në mbledhje.

1. Albiona Lamaj
2. Klaudio Alisinanaj
3. Liljana Mestuaj
4. Erald Çepele
5. Lori Musaj
6. Artan Velçani
7. Klarida Semanjaku
8. Armand Ahmetaj
9. Ertila Myrtaj
10. Smerald Hazizaj
11. Elmira Rama
12. Renaldo Shpata
13. Vjollca Kasaj
14. Novrus Toska
15. Zejni Musaj

Pra pjesëmarrja është 15 këshilltarë, kuorumi është i plotësuar, ligjor. Sipas rregullores do zgjedhim komisionin për miratimin e procesverbalit të mbledhjes së sotme.

Komisioni për verifikimin e procesverbalit të mbledhjes së sotme propozoj të jetë:

- Klaudio Alisinanaj
- Ertila Myrtaj
- Zejni Musaj

Armand Ahmetaj – Kush është dakord?

Këshilltarët shprehin dakordësinë.

Rendi i ditës është ndërtuar në bazë të gjithë procedurave ligjore dhe sipas rregullores. Para se ta lexoj doja t'ju pyesja nëse keni ndonje pikë për të shtuar apo për të hequr në rendin e ditës ? Dua t'ju kujtoj që të gjitha pikat që do shqyrtojmë sot miratohen me shumicë të thjeshtë votash. Votimi është i hapur.

Rendi i ditës.

1- Miratimi i rendit të ditës.

2- Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Këshillit datë 30.08.2024.

3- Informacion mbi vendimet e miratuara në mbledhjen e datës 30.08.2024.

4- Projekt-vendim “Mbi miratimin e projekt dokumentit të rishikuar të Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027”.

5- Projekt-vendim “Për miratimin e dhënies së ndihmës financiare z. Xhemal Mahmutaj për rehabilitimin e dëmeve të shkaktuara nga rënia e zjarrit në banesë lagjja “Naftëtari”.

6-Projekt-vendim “Për miratimin e blerjes së mjetit teknologjik për transportin e mbetjeve urbane në gjithë territorin, me fondet e çliruara në programin “Rrugë Rurale”.

7- Projekt-vendim “Për miratimin e transferimit të fondit midis programeve për shtim financimi të KUZ”

8- Projekt-vendim “Për miratimin e listës së familjeve në nevojë që përfitojnë rikonstruksion banese nga sistemi i pikëzimit”.

Armand Ahmetaj- Kush është dakord?

Miratohet me 15 vota pro abstenim ska, kundër ska.

SEKRETARE

Refaela Xeba

KRYETAR

Armand Ahmetaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PATOS  
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 3388/8 Prot.

Patos më 23.09.2024

**PROCESVERBAL**

I mbajtur sot më datë 17.09.2024 ora 14:00 , në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së dytë të rendit të ditës.

Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Këshillit datë 30.08.2024.

Armand Ahmetaj - Nëse ka ndonjë propozim, sygjërim për korrigjim procesverbali?

Nëse ska pyetje konsiderohet e ezauruar. Miratohet pika dy.

SEKRETARE  
Refaela Xeba

Flordio Alsinonoi

KRYETAR  
Armand Ahmetaj

Eshler Myrtaj  
Cekaj  
240

Lejmi Musoj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PATOS  
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 3388/9 Prot.

Patos më, 23 09.2024

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 17.09.2024 ora 14:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së tretë të rendit të ditës.

Mbi informacionin për vendimet e miratuara në mbledhjen e datës 30.08.2024

Armand Ahmetaj- Fjala për Refaelën!

Refaela Xeba- Përshëndetje të gjithëve! Në mbledhjen e datës 30.08.2024 janë marrë gjithsej 4 vendime. Nga nr. 57 deri në nr 60.

Vendimet janë zbardhur në afat dhe i janë përcjell drejtorive përkatëse për ekzekutim.

Nga këto vendime asnje nuk ishte me karakter normativ për verifikim në Prefekturë.

Më lejoni t'ju informoj se nga ana e Prefekturës kemi pasur një kontroll në vend në datën 10.09.2024, ku objekti i kontrollit ishte verifikimi i akteve normative të organit përfaqësues dhe organit ekzekutiv të Bashkisë Patos, për periudhën qershor -gusht 2024 si dhe zbatimin e rekomandimeve të lëna nga Prefekti i Qarkut Fier në përfundim të verifikimit në vend të ligjshmëriaë së akteve normative në muajin qershor 2024 .

Nga kontrolli i ushtruar përfundimet janë si më poshtë vijon:

Për mbledhjet e këshillit bashkiak për periudhën qershor-gusht 2024 nuk ka akte normative të padepozituara për verifikim ligjor te Prefekti i Qarkut Fier.

Procesverbali i mbledhjes mbahet nga Sekretari i Këshillit në përputhje me ligjin.

Për mbledhjet e radhës të zhvilluara është respektuar afati i njoftimit të rendit paraprak.

Procesverbali i mbledhjes parardhëse është i miratuar siç kërkohet nga ligji.

Për periudhën objek kontrolli nuk ka akte normative të kundërshtuara për pavlefshmëri, në Gjykatë nga Prefekti i Qarkut Fier.

Aktet me karakter normativ janë të shoqëruara me projektvendimet dhe relacionet përkatëse.

Për periudhën objek kontrolli nuk ka rekomandime për të lënë.

Faleminderit!

SEKRETARE  
Refaela Xeba

Klaudio Alisihonaj

KRYETAR  
Armand Ahmetaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PATOS  
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 3432 Prot.  
13

Patos më 23.09.2024.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 17.09.2024 ora 14:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së katërt të rendit të ditës.

Projekt-vendim “Mbi miratimin e projekt dokumentit të rishikuar të Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027”.

Ekzekutivi Relaton, Mimoza Shtëmbari- Drejore Financës.

Suela Hoxha -Këshilltare prezent në sallë.

Mimoza Shtëmbari- Përhëndetje të gjithëve!

Projekt vendimi mbi programin e rishikuar aftmesëm 2025-2027 vjen për miratim duke qënë pjesë e një procesi shumë të gjatë të hartimit të këtij dokumenti. Dihet që ky projektdokument vjen duke filluar që nga faza e parë që është dokumenti i parë i miratuar në këshillin bashkiak në qershor të 2024 pasi është bërë dhe vlerësimi i të ardhurave dhe i burimeve që vijnë nga qeveria. Mbas kësaj faze bëhet dhe rishikimi i tavanëve në bazë të procesit të dëgjësave publike. Me vendimin nr. 55 në korrik janë miratuar tavanet përfundimtarë të këtij projektvendimi dhe gjatë kësaj faze deri sot është bërë reflektimi i të gjitha tavanëve përfundimtarë të miratuar në korrik.

Gjithashtu ky projektdokument konsiston edhe me ndryshimet e marra gjatë dëgjësave publike që u bë në fazën e rishikimit ku ju jeni pjesë e këtyre dëgjësave dhe nisur nga fakti dhe nga raportet e marra gjatë këtyre dëgjësave ne kemi ndryshime në këtë rishikim të dokumentit për pjesën e zërave të buxhetit që unë do ti referohem në mënyrë të përmbledhur.

Ky dokument do të shërbej si instrument kryesor për zbatimin e buxhetit për vitin 2025 pasi është viti i parë i këtij projektdokumentit që do të futet për zbatim, në këtë fazë është i rishikuar dhe në mënyrë përfundimtare do tju vij në nëntor të këtij viti për miratim përfundimisht.

Ndryshimet në këtë rishikim kanë të bëjnë me:

Nuk ndryshojnë burimet, burimet janë ato që janë miratuar me tavanet përfundimtarë në korrik dhe me dokumentin e parë në qershor të 2024.

Gjatë kësaj periudhe me miratimin e dokumentit të parë në qershor ne dorzojmë dokumentin në Ministrinë e Financave mbasi e miratojmë në Këshillin Bashkiak. Mbas kësaj faze na vijnë mendime dhe rekomandime nga Ministria e Financave dhe ata janë në një proces standartizimi si instrument financiar për të gjitha Bashkitë e Republikës.

Janë pakësuar shpenzime korente në programin e administratës dhe janë shtuar shpenzimet për objektin ndriçim rrugor pasi dhe nga dëgjësat publike kemi pasur kërkesa dhe rrugë të pidentifikuara deri në këtë fazë dhe janë shtuar për tu mbuluar për vitin 2025.

Gjithashtu kemi ndryshime në pasqyrim midis programeve, këtë gjë e cilësova dhe më parë që ndryshuam programet midis tavanëve por gjithmonë pa ndryshuar burimet. Dhe kanë të bëjnë ndryshim midis programeve duke pasqyruar rikonstrukcionin e trotuareve që e kishim bërë në tavane të dokumentuar në dokumentin e parë te programi i infrastrukturës rrugore dhe në fakt ky i takon programit të shërbimeve publike dhe menaxhohet nga agjencia e Shërbimeve Publike.

Ndryshim tjetër ishte reflektimi i vendimit të këshillit ku rikonstruksioni i rrugës Gjinoqarë për ti ardhur më shpejt në ndihmë atij komuniteti u studiuua, u bë projekti dhe u fut në projekt të marrëveshjes për asfalto beton. E gjithë kjo vlerë në bazë të vendimit që ju miratuat u bë reflektimi në këtë dokument nga i cili pjesa e financimit për vitin 2024 kaloi për asfalto beton dhe pjesa tjetër ju shtua financimit në kopshtin me drekë për bashkinë Patos. Këto janë ndryshimet në mënyrë të përmbledhur të këtij dokumenti të rishikuar. Ndryshimet për çdo program i keni në projekt dokument edhe treguesit për çdo program.

Lori Musaj- Përshëndetje të gjithëve! Komisioni i Ekonomisë, Financës dhe Ndhimave Ekonomike i mbledhur në datë 13.09.2024 shqyrtoi projektvendimin mbi miratimin e projektdokumenit të rishikuar të programit buxhetor afatmesëm 2025-2027. Pasi diskutuan mbi këtë projektvendim u ra dakord që kjo pikë të kaloj për vendimarrje në mbledhjen e këshillit ku aty do të bëhen dhe diskutimet përkatëse.

Armand Ahmetaj –Atëherë kemi diskutime, pyetje?

Atëherë meqënëse nuk ka propozoj ta kalojmë në votim. Projekt-vendim “Mbi miratimin e projekt dokumentit të rishikuar të Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027”? Kush është dakord për pikën e katërt?

Armand Ahmetaj – Dua tju njoftoj se prezenca është shtuar me znj. Suela Hoxha. Prezent në mbledhje 16.

Miratohet me 16 vota pro, kundër ska, abstenim ska.

SEKRETARE  
Refaela Xeba



Klaudio Allosnari




KRYETAR

Armand Ahmetaj

Eshiter Myrtaj



Lejla Musaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PATOS  
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 1970 Prot.

Patos më 23 09.2024.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 17.09.2024 ora 14:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së pestë të rendit të ditës.

Projekt-vendim “Për miratimin e dhënies së ndihmës financiare z. Xhemal Mahmutaj për rehabilitimin e dëmeve të shkaktuara nga rënia e zjarrit në banesë lagjja “Naftëtari”.

Arben Shpërdheja- Z. Xhemal Mahmutaj ka paraqitur kërkesën me nr.1970 prot., datë 23.07.2024, për verifikimin e dëmeve të shkaktuara në banesë në lagjen “Naftëtari” nga rënia e zjarrit dhe për ndihmë për rehabilitimin e saj. Për verifikimin e kërkesës së qytetares është ngritur komisioni me urdhërin nr. 152, nr.1970/1 prot., datë 25.07.2024 i përbër nga :

- a. Ina Sauli
- b. Arben Shpërdheja
- c. Andi Kola
- d. Edona Beqaj
- e. Gazmira Plesati

Komisioni bëri verifikimin e dëmeve të shkaktuara nga rënia e zjarrit në banesën e z. Xhemal Mahmutaj, referuar deklaratës së tij, u hartua preventivi për zërat e orendive të dëmtuara. Në bazë të V.K.M-së nr. 329, datë 16.5.2012, “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore” të dëmtuarit i jepet ndihmë financiare 50% e vlerës. Bazuar preventivit të hartuar vlera e dëmit të shkaktuar në banesën e z. Xhemal Mahmutaj është përlloritur në vlerë 300,597 lekë. Në këto kushte i propozojmë Këshillit të bashkisë, të miratoj një ndihmë financiare me vlerë 150,000 (njëqindë e pesëdhjetë mijë) lekë për rehabilitimin e banesës.

Lori Musaj- edhe ky projektvendim është diskutuar në mbledhjen e komisionit datë 13.09.2024. Pas shqyrtimit të projektvendimit dhe materialeve të tjera shoqëruese ne si komision kemi menduar të shikohet mundësia ligjore që në preventivin për dëmshpërblim të shtohet vlera e pajisjeve elektroshtëpiake të përshkruara në procesverbalin e konstatimit ose të shpjegohet ligjërisht pamundësia e kësaj shtese.

Arben Shpërdheja- Rekomandimet e këshillit në mbledhjen e datës 13 shtet u diskutua dhe nga komisioni i ekonomisë u morën parasysh nga ekzekutivi dhe në bazë të kërkesës pavarësisht se disa zëra punimesh nuk janë shkruar për vlerësim, vet qyterari kërkon ndihmë financiare për rehabilitimin e dëmeve të shkaktuara, pra për banesën e tij dhe bashkia e ndodhur në këto kushte duke parë dhe pjesën buxhetore është e mendimit për këtë vlerë.

Armand Ahmetaj – kemi diskutime të tjera?

Atëherë propozojë të kalojmë në votimin e pikës së pestë Projekt-vendim “Për miratimin e dhënies së ndihmës financiare z. Xhemal Mahmutaj për rehabilitimin e dëmeve të shkaktuara nga rënia e zjarrit në banesë lagjja “Naftëtari”.

Kush është dakord?

Miratohet me 16 vota pro, abstenim ska, kundër ska

*Kludio Abismonej*



SEKRETARE

Refaela Xeba



KRYETAR

Armand Ahmetaj

*Ebela Myrte*

*Armand Ahmetaj*  
24

*Lejla Musaj*







REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PATOS  
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 3384 / 3 Prot.

Patos më 23.09.2024

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 17.09.2024 ora 14:00 , në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së gjashtë të rendit të ditës.

Projekt-vendim “Për miratimin e blerjes së mjetit teknologjik për transportin e mbetjeve urbane në gjithë territorin, me fondet e çliruara në programin “Rrugë Rurale”.

Armand Ahmetaj- Ftojmë ekzekutivin.

Ermenita Mici – Përshëndetje të gjithëve! Një nga detyrimet që bashkia Patos ka ndaj qytetarëve të saj është pikërisht ofrimi i shërbimit të pastrimit të qytetit. Aktualisht ky shërbim mbulohet nga Agjencia e Sherbimeve Publike të cilat disponojnë vetëm një mjet funksional i cili pastron mbi 300 kontinier në të gjithë territorin e bashkisë Patos. Përsa i takon gjendjes së këtij mjeti kemi të bëjmë me një mjet që është pothuajse totalisht i amortizuar, i cili ka një vit prodhimi 1991 dhe nga bashkia Patos është blerë në vitin 2007, dhe mund të themi që kemi mbi 15 vite përdorim të këtij mjeti në shërbim të komunitetit.

Nga përlllogaritja që është bërë kostoja e blerjes së këtij mjeti është barazuar me koston e amortizimit që do të thotë ky shërbim pengohet nga prania e këtij mjeti i cili ka nevojë për servise dhe procedura të cilat ta bëjnë atë të funksionoj sa më mirë ky shërbim. Nga përlllogaritja shohim që ky mjet ka dhe një kosto të lartë mirëmbajtje dhe në këto kushte vështirësohet shërbimi i pastrimit. Prandaj është parë e arsyeshme që të mundësohet blerja e një mjeti të ri për fondet me të cilat do të vijjnë nga çlirimi nga prokurimi i objektit që është rikonstrukcioni i rrugës L. e Re Përroi Çam dhe struktura buxhetore është përcaktuar dhe në vendim dhe në këto kushte i kërkojmë këshillit bashkiak të miratoj vlerën e mjetit teknologjik për transportin e mjeteve urbane në të gjithë territorin e bashkisë me vlerë 11,346,000 leke.

Lori Musaj- Komisioni i ekonomisë pasi shqyrtoj projektvendimin e mësipërm konstaton se përmbajtja e projektvendimit është argumentuar në përputhje me bazën ligjore si dhe vendos ta miratoi pa asnjë ndryshim me katër vota pro.

Erald Çepele- Automjeti është parashikuar të mërret i ri me 0 km apo i përdorur ?

Ermenita Mici- Është kërkuar të bëhet studimi i tregut, janë parë oferta nga operatorët të ndyshëm dhe do të vlerësohet. Aktualisht mund të them që i jemi referuar një vit prodhimi mbi 2016.

Artan Velçani- Sa automjete kemi?

Ermenita Mici- Janë dy, njëri e kryen shërbimin, njëri nuk funksionon.

Armand Ahmetaj – Nëse s’kemi diskutim tjetër unë propozoj ta kalojmë në votim pikën e gjashtë, Projekt-vendim “Për miratimin e blerjes së mjetit teknologjik për transportin e mbetjeve urbane në gjithë territorin, me fondet e çliruara në programin “Rrugë Rurale”.

Kush është dakord?

Kundër ska, abstenim ska, miratohet me 16 vota pro.

SEKRETARE

Refaela Xeba

KRYETAR

Armand Ahmetaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PATOS  
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 3386/13 Prot.

Patos më 23.09.2024.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 17.09.2024 ora 14:00 , në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së shtatë të rendit të ditës.

Projekt-vendim “Për miratimin e transferimit të fondit midis programeve për shtim financimi të KUZ”

Boreta Murati- Një nga problematikat e vazhdueshme në qytet dhe në lagje të qytetit është sistemimi i ujërave të zeza të cilat janë të disiplinuar deri në një pikë të caktuar dhe më pas vazhdojnë në rrjedhje të lirë për t’u shkarkuar në pikën përfundimtare. Nisur nga kjo problematikë të cilat janë evidentuar dhe në terren për ndërhyrje dhe një pjesë e tyre janë emergjente pasi kalojnë në zonë të banuar dhe përbën problem për banorët në afërsi duke qënë shkak i sëmundjeve të ndryshme dhe përhapjes së tyre. Është menduar ndërhyrja për sistemimin e ujërave të zeza në :

Në fshatin Dukas Breg –ndërhyrja në këtë segment do të bëhet në një gjatësi me  $d= 200$  metër linëar. Është menduar ndërhyrja me tubo të brinjëzuara me  $d= 200$  mm dhe do të bëhet shkarkimi i tyre në pusetën e pozicionuar në rrugën kryesore. Gjithashtu do të bëhet dhe ndërtimi i pusetave të kontrollit me dimensione sipas projektit të miratuar.

Në fshatin Kuqar, në lagjen e fshatit në këtë segment është menduar ndërhyrja pasi ujërat e zeza shkarkohen në sipërfaqe të hapur në kanalën e rrugës i cili është i hapur me sipërfaqe të hapur dhe zona është e banuar

Shkarkimi i ujërave të zeza është menduar të bëhet në përrua dhe për këtë nevojiten tubo të brinjëzuara me  $d=315$  mm me gjatësi 200 ml.

Në fshatin Margëlliç – Është menduar ndërhyrja në 4 segmente si:

Segmenti i parë me gjatësi 60 ml ku bëhet derdhja në gjendje të lirë në afërsi të zonës së banuar për disiplinimin është menduar ndërhyrja me tubo të brinjëzuara me  $d=200$ mm dhe shkarkimi do të bëhen në kanalën e rrugës nga ku do bëhet takimi me ujërat e bardha dhe më pas do të shkarkohen në pusetën qendrore të kuz.

Vazhdim i kuz në rrugën e Lapidarit, Vitin e kaluar ne kemi bërë një investim në rrugën e lapidarit ku është bërë shkarkimi i ujrave të zeza në të gjithë zonën e banuar she shkarkimi i tyre është bërë në rrugën kryesore. Tani është menduar që të vazhdohet ky investim për në pusetën që duhet të jëtë po themi gati 100 ml më shumë për tu lidhur me investimin ekzistues dhe të bëhet shkarkimi në përrua.

Është menduar rikonstruksioni i pusetave ekzistuese dhe shtim i linjës së kuz me gjatësi 30 ml për derdhjen e ujërave në destinacionin final.

Vazhdim linje kuz është menduar ndërhyrja në këtë segment pasi është e pozicionuar puseta kryesore dhe bëhet grumbullimi i gjithë ujërave të zeza të zonës së banuar, derdhja e këtyre ujërave do të bëhet në përrua, për këtë nevojiten tubo të brinjëzuara me gjatësi 200 ml

Në lagjen Mustafa Matohiti – Për shkak të formacionit të paqëndrueshëm të tokës janë dëmtuar pusetat ekzistuese, për këtë arsye është menduar riparimi i pusetave dhe shtim i linjës për derdhjen e tyre në destinacionin final (në përrua).

Lagja e Re, Vresht – Zgjatim rrjeti kuz dhe largim i ujërave të zeza nga zona e banuar për tek puseta kryesore e cila bën derdhjen përfundimtare në përrua. Për këtë ndërhyrje nevojiten tubo të brinjëzuara me gjatësi L=300ml.

Ndërtim rrjeti kuz në lagjen e Re, me gjatësi L=250ml, Shkarkimi do të bëhet në përroin që mendohet se do të rehabilitohet.

Vazhdim rrjeti Kuz në lagjen e Re largimi i ujërave nga zona e banuar me gjatësi L=200 ml, kjo do të bëhet me tubo të brinjëzuara.

Lagja Mustafa Matohiti – Ndërtim rrjeti i ri kuz në rrugën e Oficinës për largimin e ujërave të zeza me gjatësi L=36 ml, dhe do shikohet mundësia për tu shtuar, në zonat e banuara pasi derdhja aktualisht bëhet në kanal in anës rrugës dhe përbën shkak i sëmundjeve të ndryshme dhe përhapjes së tyre.

Fshati Rrerës – Largimi i ujërave të zeza nga zonat e banuara dhe derdhja e tyre në përrua, segmenti është me gjatësi 160 ml dhe tubo të brinjëzuara. Vlera e projektit do të sigurohet nga çlirimi i fondit nga objekti “Ndërtim mure mbajtës në qytet dhe rrethina” në vlerën prej 2,557,006 lekë me tvsh.

Për ndjekjen dhe zbatimin e tyre ngarkohet Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të territorit dhe Drejtoria e Financës.

I kërkojmë këshillit të miratojë transferimin e fondit midis programeve për shtim financimi të vlerës 2,557,006 lekë në investimin e rrjetit të KUZ.

Lori Musaj- Komisioni i ekonomisë pasi shqyrtoj projektvendimin e mësipërm dhe vendos ta miratoi pa asnjë ndryshim me katër vota pro.

Novrus Toska- Kur do të përfundoj projekti kuz në fshatin Verbas?

Bora Murati – Nuk kam informacion për këtë pjesë besoj se do ta merni një përgjigje më vonë.

Renaldo Shpata- Kur është menduar ndërhyrja në këto zona? Mund të realizohen brenda këtij viti?

Bora Murati – Besoj se po, sapo të mbarojnë procedurat ne jemi gati të vazhdojmë më tenderimin dhe blerjen e bazës materiale. Sepse është menduar që ndërhyrja do të bëhet nga agjencia. Në disa segmente mendoj se do të ndërhyhet brenda këtij viti.

Armand Ahmetaj – Nëse s’kemi diskutim tjetër unë propozoj ta kalojmë në votim pikën e shtatë.

Projekt-vendim “Për miratimin e transferimit të fondit midis programeve për shtim financimi të KUZ”

Kush është dakord? Kundër ska, abstenim ska, miratohet me 16 vota pro.

SEKRETARE

Refaela Xeba

KRYETAR

Armand Ahmetaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PATOS  
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 3385 Prot.

13

Patos më 23.09.2024.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 17.09.2024 ora 14:00 , në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së tetë të rendit të ditës.

Projekt-vendim “Për miratimin e listës së familjeve në nevojë që përfitojnë rikonstruksion banese nga sistemi i pikëzimit”.

Bazuar kërkesave të paraqitura nga qytetarët për rikonstruksion banese për familjet në nevojë, 18 (tetëmbëdhjetë) kërkesa, komisioni i strehimit pasi shqyrtoi kërkesat e paraqitura dhe dokumentacionin përkatës bëri vlerësimin për çdo dosje, sipas vendimit të K. Bashkiak me nr. 16, datë 29.02.2024 me nr. 497/2 prot., datë 07.03.2024, dhe arriti në këtë përfundimin e Listës emërore e familjeve përfituese si më poshtë:

1. Vasiliqi Pleqi	42 pikë
2. Kozeta Bajrami	40 pikë
3. Goni Semanjaku	36 pikë
4. Pajtim Grëmbi	31 pikë
5. Dhora Mëhilli	31 pikë
6. Arben Osmani	30 pikë
7. Artur Toska	29 pikë
8. Myftar Sorraj	29 pikë
9. Nexhip Shpata	29 pikë
10. Mehdi Toska	27 pikë
11. Artur Bregu	
12. Xhovan Kovaçi	

- Në bazë të procesvebaleve nuk u kualifikuan 4(katër) familjë pasi objektet e tyre nuk plotësojnë kushtet teknike për rikonstruksion të paraqitur si më poshtë:

1- Avni Bregu

2- Gëzim Akulli

3- Liri Qallhaj

4- Riza Memaj

Kërkesa e paraqitur nga qytetarja Kaliopi Tole është trajtuar nga bashkia Patos në vitin 2022-2023 për këtë arsye s'kualifikohet.

Qytetarja Kristina Simakaj nuk është vlerësuar nga komisioni pasi kërkesa e saj është paraqitur me vonë dhe komisioni kishte bërë vlerësimin, për këtë arsye komisioni kishte mbyllur procesin e vlerësimit dhe do të kaloj për vitin tjetër

Qytetarët si më poshtë:

1- Artur Bregu

2- Xhovan Kovaçi

janë miratuar me vendim këshilli Bashkiak, por janë rivendosur në këtë listë për arsye se ka ndryshuar çmimet e zërave të punimeve sipas vendimit nr. 216, datë 13.4.2023 "Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim".

Vlera për rikonstruksion e banesave për vitin 2024 është miratuar me vendimin K. Bashkiak nr. 81 datë 18.12.2023 në programin buxhetor "Strehimi Social", me zërin Rikonstruksioni i banesave të kushteve të papërshtatshme për familjet në nevojë", në vlerën 5,153,623 (pesë milion e njëqind e pesëdhjetë e tre mijë e gjashtëqind e njëzet e tre) lekë.

Kjo vlerë është shpërndarë për rikonstruksionin e 12 (dymbëdhjetë) familjeve me preventiv të ndarë sipas kushteve të objektit përkatës.

Konkretisht në zërat e punimeve rikonstruksioni pjesshëm për rifiniturën, suvatime të brendshme, riparim çatie ekzistuese, ndërtim tavane, punime shtresash, hidroizolim tarrace, lyerje me bojë dhe zëvendësim dyer dritaresh. Ky fond është parashikuar për blerje bazë materiale dhe punimet do të kryhen nga Agjencia e Shërbimeve Publike

Lori Musaj- Komisioni i ekonomisë pasi shqyrtoj projektvendimin e mësipërm dhe vendos ta miratoi pa asnjë ndryshim me katër vota pro.

Erald Çepele- Kam një pyetje për qytetarin Dhora Mëhilli në fshatin Verbas duke qënë se jam marrë personalisht me problemin e këtij qytetari dhe për dy-tre të tjerë kam dyshime te vlera e përcaktuar. Mesa kam dijeni unë është kërkuar nga qytetari bërja e një çatie pasi është me strukturë betoni të viteve 90 strukturë e hollë e lehtë që deporton edhe lagështinë por edhe të nxehtin njëkohësisht. Vlera është jo e konsiderueshme për të bërë një mbulesë çatie, për blerjen e bazës materiale duke i ditur dhe çmimin. Për mua është vlera shume e ultë dhe unë nuk jam dakord.

Arben Shpërdheja- Kërkesa e Arjan Mëhillit me kryefamiljare Dhora Mëhilli është vlerësuar nga komisioni, është bërë verifikimi në vend, kërkesa e tij ka qënë për çatinë. Komisioni inxhiniero teknik vendosi pavarësisht pretendimeve të qytetarit mbulesa e tij është me soletë dhe do të bëj hidro izolim.

Klarida Semanjaku- 18 familje kanë aplikuar? Se mesa di unë ka aplikuar dhe një familje nga fshati Kiço Koçi, që ka dy persona me aftësi të kufizuar dhe më duket ka aplikuar për një riparim çatie. Jeni në dijeni apo jo?

Arben Shpërdheja- Një kërkesë e tillë nuk ka ardhur pranë nesh. Në këtë listë prej 18 familjesh është përjashtuar vetëm Hadile Lazaj në fshatin Drenie, kemi vajtur disa herë dhe me anë të kryeplakut kemi marrë vesh që kjo zonjë jeton në Fier dhe këtë e do për shtëpi verore. Asnjë tjetër nuk është përjashtuar nga kërkesat.

Klaudio Alisininaj- Mos ka ndonjë mosrakordim këtu se ne në mbledhjen e komisionit nuk e kishim këtë preventivin se këtu shuma është 4 milion e 700 mijë lekë ndërsa në fillim e kemi 5 milion e 153.

Mos ka ndonjë mosrakordim?

Arben Shpërdheja- Vlera e miratuar me vendim të këshillit bashkiak për këtë zë buxhetor vitin që shkoj është 5 milion e 100 lekë .

Klaudio Alisinanaj- Ky është zëri që kemi miratuar në buxhet, e kuptova, e qartë.

Pyetja e dyte. Që pas mbledhjes së fundit ku ne kemi miratuar sistemin e pikëzimit çfarë hapash janë ndjekur? A është bërë ndonjë njoftim publik? Mënyra e mbledhjes së dokumentave? Mënyra e përzgjedhjes? Afatet? Çfarë hapash janë ndjekur që nga shkurti deri tani?

Arben Shpërdheja- Deri në miratimin e kësaj vlere në buxhet janë bërë dëgjесat publike para se të bëhej buxheti, të gjithë qytetarët janë të informuar si dhe këshilltarët sepse jeni pjesë e kësaj dëgjese. Ne merremi me kërkesat që paraqiten. Ligji përcakton dokumentacionin përkatës për çdo familje. Për këto 18 dosje janë mbledhur gjithë dokumentacioni dhe nuk kemi refuzuar asnjë qytetar.

Zv/kryetare- Kërkesat që kanë qënë në bazë të formularit të pikëzimit, janë marrë të gjitha dokumentacionet që kanë paraqitur qytetarët dhe në bazë të tyre në bazë të gjithë dokumentacionit që plotësojnë dhe në bazë të kriterëve që plotësojnë është bërë pikëzimi. Edhe kur ka pasur raste që kanë ardhur më mbrapa ne i kemi pranuar kemi pasur lehtësira. I vetmi rast ka qënë me vones pasi është mbyllur faza e preventivimit. Dhe aty ishte e vështirë ndërhyrja pasi kishim kaluar dhe vlerën në këshill.

Armand Ahmetaj – Nëse skemi diskutim tjetër unë propozoj ta kalojmë në votim pikën e tetë Projekt-vendim “Për miratimin e listës së familjeve në nevojë që përfitojnë rikonstruksion banese nga sistemi i pikëzimit”.

Kush është dakord?

Miratohet me 15 vota pro, I kundër, abstenim ska.

SEKRETARE  
Refaela Xeba



Klaudio Alisinanaj



KRYETAR  
Armand Ahmetaj

Eshila Myrtezi

Lejla Musaj

